

POLITIKA E PRIVATËSISË

Në këtë dokument jepet një informacion i detajuar në lidhje me administrimin dhe përpunimin e informacionit dhe të dhënave personale të përdoruesve që vizitojnë faqen e internetit të Landeslease sh.a. Me hyrjen në këtë faqe interneti apo me plotësimin e çdo aplikimi online (kur është e aplikueshme), përdoruesi deklaron se jep miratimin e tij për procesimin e mëtejshëm të informacionit nga ana e Landeslease sh.a. Faqja <https://landeslease-al.com/> është faqja zyrtare në internet e Landeslease sh.a. Landeslease mbledh të dhëna me karakter personal të përdoruesve (subjektet e të dhënave personale) të cilat regjistrohen në sistemet e saj apo të ofruesve të tjerë të shërbimeve të autorizuar prej saj. Në këtë faqe, përdoruesi mund të hasë në forma të ndryshme, aplikime për punë, akses në shërbimet online, aplikim për ankesa të ndryshme etj.

Të dhënat personale që japin përdoruesit, përdoren vetëm për qëllimin e ofrimit të shërbimeve ose plotësimin e kërkesës dhe i komunikohen ofruesit të shërbimit dhe palëve të treta, vetëm nëse nevojitet për këtë qëllim, duke respektuar kërkesat e ligjit.

Asnjë informacion që rezulton si rezultat i ofrimit të shërbimit nuk komunikohet ose shpërndahet përveç rasteve kur informacioni kërkohet nga organet kompetente që e fitojnë këtë të drejtë me ligj të veçantë duke respektuar kërkesat e ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Landeslease thekson se ofrimi i të dhënave personale të përdoruesve nëpërmjet plotësimit të formularëve të ndryshëm nuk është i detyrueshëm dhe është në dëshirën e çdo subjekti për të dhënë vullnetarisht informacionin e kërkuar për të krijuar dhe vijuar me tej marrëdhënien e biznesit me përdoruesit. Në rast se përdoruesi nuk pranon të vërë në dispozicion të Landeslease këto të dhëna, Landeslease mund të refuzojë lidhjen e një kontrate, ose nuk do të jetë në gjendje të vazhdojë ekzekutimin e një kontrate ekzistuese, ose mund të jete e detyruar të ndërpresë këtë kontratë në vijim.

Përdoruesit duhet të vënë në dispozicion të Landeslease ato të dhëna që kërkohen të mblidhen bazuar në ligjet në fuqi apo rregullore të ndryshme. Përpunimi i të dhënave personale mund të kryhet edhe në rastet e përmbushjes së detyrimeve të ndryshme ligjore për institucionet financiare, për Parandalimin e Pastrimit të Parave, për Taksat, për ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore etj. Kur është e nevojshme, të dhënat e përdoruesve përpunohen edhe për të mbrojtur interesat e ligjshme të Landeslease ose të palëve të treta.



Në rast se Landeslease duhet t'ua transmetojë të dhënat e mbledhura palëve të treta (partnerë të saj në biznes), Landeslease siguron subjektet se këto të dhëna përdoren vetëm për qëllimin e realizimit të shërbimit leasing për qëllimin për të cilin përdoruesi ka deklaruar vullnetarisht të dhënat e tij personale. Në këto raste Landeslease siguron përdoruesit se kontratat e lidhura me të tretët për këtë qëllim janë të qarta dhe në to parashikohen kushtet e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit.

Bazuar në ligjin Nr. 9887 datë 10.03.2008 përdoruesi – subjekt i të dhënave personale, në çdo moment pasi të ketë dhënë vullnetarisht informacionin e kërkuar, i lind e drejta që, nëpërmjet një kërkesë pranë Landeslease, të aksesojë këto të dhëna, të verifikojë saktësinë e tyre si dhe të kërkojë korrigjimin apo edhe përditësimin e tyre duke u bazuar plotësisht në nenin 13 të ligjit nr. 9887.

Theksojmë se bazuar në nenin 16 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", përdoruesi (subjekti i të dhënave personale) gëzon të drejtën e ankimit në rast se pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm në lidhje me të dhënat personale. Në rast se subjekti i të dhënave ka bërë ankim, Landeslease nuk do të kryejë ndryshime në të dhënat e tij personale deri në dhënien e vendimit. Kërkesat duhet të drejtohen në adresën **info@landeslease-al.com** ose dërgohen në adresë të shoqërisë: Landeslease, Njësia Administrative nr. 5, Rruga Ismail Qemali, Nr.32/1, Shk.1, Kati 3, Tiranë, Shqipëri.

Ankesat nga përdoruesit (subjekte të të dhënave personale) mund të adresohen me e-mail edhe pranë Komisionerit për Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në adresën e mëposhtme: **info@idp.al**.

Të dhënat personale ruhen për aq kohë sa është e nevojshme për marrëdhënien e biznesit me Landeslease në përputhje me detyrimin për ruajtje bazuar në Kodin Civil, Ligjin për Arkivat, Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave, etj.